



REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	07/06/2024		
Nr. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01	060/01-	27510	



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 07.06.2024

Ftesë

Për pjesëmarrje në takim lidhur me dëgjimin e parë publik për Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027

Duke u bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, Statutin e Komunës së Drenasit, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Udhëzimin Administrativ të MAPL-së Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komuna, Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci së bashku me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa dhe Zyrën për Komunikim me Publikun, publikojnë kalendarin për organizimin e dëgjimeve me publike me qytetarë për përgatitjen e KAB-it (Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027).

Njoftohen të gjithë qytetarët e Komunës së Drenasit, administratorë të vendbanimeve, përfaqësues të lagjeve, OJQ-të, shoqata e grave, shoqëria civile, biznese të Komunës së Drenasit dhe gjithë të interesuarit, se më datën **13.06.2024**, do të fillojnë dëgjimet buxhetore për të diskutuar **Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2025-2027**.

Korniza Afatmesme Buxhetore dhe Draft- Buxheti Komunal 2025-2027 janë të një rëndësie të veçantë për Komunën e Drenasit, prandaj ju qytetarë të nderuar, shfrytëzoheni të drejtën tuaj që të jeni pjesëmarrës aktiv në këto dëgjime publike, ku me propozimet dhe vërejtjet e juaja, ju do të kontribuoni në përmirësimin e cilësisë së jetës suaj.

KAB-i do të jetë në konsultim publik nga **07.06.2024** deri më **18.06.2024**, ndërsa, konsultimet publike me qytetarë do të mbahet më **13.06.2024** në sallën e Kuvendit në orën **10:30** dhe në ora **14:00**.

Komentet dhe sugjerimet mund t'i dërgoni deri më 18.06.2024 në orën 16:00, në e-mail-at e zyrarëve: albulena.saliuku@rks-gov.net; bekim.dobra@rks-gov.net avdyl.mziu@rks-gov.net dhe komuna.drenas@rks-gov.net

Për më shumë detaje, për organizimin e konsultimit publik për KAB-in, mund t'i referoheni qarkoreve në vegëzat:

Ueb faqen zyrtare në rubrikën planet në konsultim publik:
<https://kk.rks-gov.net/gllogoc/category/raportet/>

Platformën për Konsultime Publike:
<https://konsultimet.rks-gov.net/>

Facebook: <https://www.facebook.com/komunadrenas/>

Më poshtë gjeni vendin e mbajtjes së dëgjimeve:

Dëgjimet publike për KAB 2024	Data e mbajtjes së dëgjimeve	Vendi	Ora
Dëgjimi i parë publik me grupe të nënperfaqësuar (administratorë të vendbanimeve, këshillat lokale, gra, të rinj, student, pensionistët, personat me aftësi të kufizuara, punëtor shëndetësor, etj).	13.06.2024	Salla e Kuvendit	10:30
Dëgjimi i dytë publik me grupe të interesit (biznese, fermerë, OJQ-të, shoqëri civile, klubet sportive, klubet artistike, etj).	13.06.2024	Salla e Kuvendit	14:00

Ju mirëpresim!

